



10-01-19

*[Handwritten signature]*

REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2018:057064

Datë: 03.12.2018

Numri i dokumentit: 00181088

P.nr.2911/17

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal, Gjyqtarja e vetme gjykuese Hakile Ilazi, me praktikanten e kësaj gjykate Marigona Shaqiri, në çështjen penale kundër të akuzuarit [REDACTED] për shkak se ka kryer veprën penale shantazh ne tentative nga neni 341 par.1 lidhur me nenin 28 të KPRK-së, sipas Aktakuzës: PP/II.nr.539-4/2015 te dt.17.11.2017, të Prokurorisë Themelore në Ferizaj-Departamenti i Përgjithshëm, pas përfundimit të shqyrtimit fillestar të mbajtur me datë 26.10.2018 në praninë e Prokurorit te Shtetit Bahri Hyseni, dhe të akuzuarit te njëjtën dite mori dhe publikisht shpalli kurse me date 06.11.2018 përpiloi me shkrim këtë:

AKTGJYKIM

I akuzuari: [REDACTED] i lindur me [REDACTED], nga i ati [REDACTED] dhe nena [REDACTED] e gjinisë [REDACTED] i martuar, prind i dy fëmijëve, ka te kryer shkollën e mesme, punëtor ne kafiterine [REDACTED] i gjendjes se dobët ekonomike ,shqiptar, shtetas i Republikës se Kosoves.

## ËSHTË FAJTOR

### SEPSE:

Nga data 24 Shkurt 2015 deri me 14 Mars 2015, i pandehuri me qellim te përfitimit te kundërligjshëm te dobisë pasurore, përmes rrjetit social "Facebook" ka kanosur te dëmtuarën [REDAKTUAR], ne atë mënyrë qe nëse nuk ia jep 100 euro do te zbulohet një fotografi ne te cilën shihet kinse e dëmtuara duke dal nga një restorant me një mashkull, ndërsa me date 14 Mars 2015 rreth orës 12:55 ne Qendrën Tregtare "Viva Fresh Store", i pandehuri kishte shkuar qe t'i marre paratë, mirëpo ishte kapur nga ana e policisë dhe ishte arrestuar.

me te cilën kreu veprën penale shantazh ne tentative nga neni 341 par.1 lidhur me nenin 28 te KPRK-se.

Prandaj, gjykata në bazë të neneve 4, 7, 17, 21, 41, 42, 43, 46, 49, 50, 51,52, 73, 74, si dhe në bazë të neneve 359 dhe 365 të KPPRK-së, te akuzuarin e

## GJYKON

- DENIM ME KUSHT- prej 7 (shtate) muajve burgimi cili dënim nuk do të ekzekutohen në qoftë se i akuzuari brenda periudhës kohore prej dy /2/ viteve pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi nuk kryen vepër tjetër penale ( koha verifikimit).

dhe

- DENIM ME GJOBE- ne shumen prej katërqind /400/ euro, te cilin dënim i akuzuari është i obliguar ta paguaje brenda afatit prej tridhjete /30/ ditësh nga momenti kur ky aktgjykim merr formën e prere nen kërcënimin e përmbarimit te dhunshëm.

- Nëse dënimi me gjobe nuk mund të ekzekutohet në ndonjërin nga mënyrat e përcaktuara me nenin 46 të KPRK-se, i njëjti do të zëvendësohet me dënim me burgim, ashtu që një ditë burg do të jetë ekuivalente me 20 euro dënim me gjobe që nuk është paguar (Neni 46 par 3 i KPRK-se.)
- E dëmtuara [REDAKTUAR] për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet në kontest civil
- Konform dispozitave të nenit nenit 450 par. 1 dhe 2 pika 2.6 lidhur me nenin 453 par. 1 të KPRK-së, obligohet i akuzuari që të paguajë paushallin gjyqësor në shumën prej 20/njëzetë/ euro në afatin prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh pasi që aktgjykimi të marrë formën e prerë nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm.
- Obligohet i akuzuari që të paguajë shumën prej 30/tridhjetë/ eurove në Fondin për Kompensimin e Viktimave të Krimit brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarrimit me dhunë.

### A r s y e t i m i

Gjykata pasi studioi materialet e çështjes penale të paraqitur për gjykim, çmoi se çështja është në juridiksionin e saj dhe gjykimi i kësaj çështje penale duhet të realizohet përpara kësaj gjykate. Po kështu është në kompetencën lëndore dhe territoriale të kësaj gjykate, pasi vepra penale për të cilën është proceduar i pandehuri gjykohet nga gjyqtarja e vetme gjykuese.

PTH në Ferizaj me aktakuzën PP/II.nr.539-2/2015 të dt.17.11.2017, ka ngarkuar të akuzuarin [REDAKTUAR] për veprën penale shantazh në tentative nga neni 341 par.1 lidhur me nenin 28 të KPRK-së, duke propozuar që i akuzuari të shpallet fajtor dhe ti shqiptohet sanksion penal i paraparë me ligj.

Gjykata duke vepruar sipas kësaj akuze caktoi dhe mbajti shqyrtimin fillestar me datë 26.10.2018 në të cilën shqyrtim gjyqësor prokurori i shtetit në fjalën përfundimtare ka theksuar se mbetet në tërësi pranë aktit akuzues dhe kualifikimit juridik dhe se gjendja faktike si në

dispozitiv të aktakuzës është vërtetuar edhe në seancën e sotme gjyqësore për faktin se i akuzuari e ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar.

I akuzuari pasi është njoftuar nga gjykata në kuptim të nenit 246 të KPRK-se, lidhur me të drejtën për të deklaruar lidhur me fajësinë apo pafajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar në shqyrtimin fillestar ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale të cilën e ngarkon aktakuza për të gjitha pikat e saj, dhe është i vetëdijshëm për pranimin e fajësisë dhe pasojat që mund të vijnë nga ky pranim, shpreh keqardhje dhe është i penduar thellë për veprën e kryer, i premtoi gjykatës se në të ardhmen nuk do të përsërisë vepra të tilla penale dhe se është mbajtës i familjes andaj kërkoi nga gjykata që të merr parasysh rrethanat e lartshënuara dhe t'i shqiptoj një dënim sa më të butë.

Prokurori i Shtetit Bahri Hyseni duke shprehur mendimin e saj përkitazi me pranimin e fajësisë, ka theksuar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, se pranimi i fajësisë është bërë konform dispozitave ligjore dhe se ky pranim i fajësisë është i mbështetur në provat dhe shkresat që përmban aktakuza, prandaj i propozoi gjykatës që të këtë parasysh pranimin e fajësisë.

Me që i pandehuri ka pranuar fajësinë gjyqtari i vetëm gjykues ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kërkesat e përcaktuara me dispozitën e nenit 248 par.1 lidhur me nenin 326 të KPPK-së:

-i pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit,

-pranimi është bërë vullnetarisht nga i pandehuri,

-pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit, dhe në provat tjera të cilat gjenden në shkresën e lëndës siç janë: kallëzimi penal i policisë me nr.2015-CF-0552 i datës 17.04.2015, vërtetimi mbi kthimin e sendeve të sekuestruara përkohësisht i datës 20.03.2015, procesverbali mbi intervistimin e të dyshuarit i datës 14.03.2015, procesverbali mbi intervistimin e dëshmitarit i datës 14.03.2015, procesverbali mbi marrjen në pyetje të viktimës i datës 14.03.2015 si dhe në të gjitha fotografitë dhe shkresat e tjera që gjenden në dosjen e lëndës.

Me qenë se i akuzuari ka pranuar fajësinë e cila është në përputhje me kriteret e përshkruara më lartë, andaj gjyqtarja konform nenit 248 paragrafit 4 lidhur me nenin 326 të KPPK-së, ka vlerësuar se nuk është e nevojshme vërtetimi i ndonjë fakti relevant për shqiptimin e dënimit dhe për këtë arsye ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurit ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale shantazh ne tentative nga neni 341 par.1 lidhur me nenin 28 të KPRK-së, ashtu siç është theksuar edhe ne dispozitiv të këtij aktgjykimi të përshkruar ne datën, vendin, kohën dhe mënyrën apo rrethanat e kryerjes.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat ne kuptim të nenit 73 të KPRK-së, dhe gjeti si rrethanë veçanërisht lehtësuese gjeti faktin se i akuzuari e ka pranuar fajësinë, duke shprehur pendimin e sinqertë dhe real për veprën penale të kryer, se deri më tani nuk rezulton të jetë dënuar me ndonjë aktgjykim të formës së prerë, faktin se i akuzuari i ka premtuar gjykatës se ne te ardhmen nuk do të përsërisë veprë tjetër penale, se është mbajtës i familjes, ndërsa sa i përket rrethanave renduese gjykata nuk gjeti ndonjë rrethanë renduese përveç që vlerësoje shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit si dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale. Andaj duke marrë parasysh tërësinë e këtyre rrethanave, të akuzuarit i shqiptoi dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me bindjen se në rastin konkret do të arrihet qëllimi i dënimit ne kuptim të preventives speciale dhe asaj gjenerale, ku një dënim i tillë është adekuat dhe në proporcion të drejtë në raport me peshën e veprës penale, rrethanave të kryerjes së veprës penale, shkallen e përgjegjësisë penale dhe personalitetin e të akuzuarit.

Vendimi mbi udhëzimin e realizmit të kërkesës pasurore-juridike është marrë ne kuptim të nenit 463 par.1 dhe 2 të KPPRK-se.

Vendimi mbi shpenzimet paushalle është marrë në kuptim të dispozitës së nenit 453 par. 1 lidhur me nenin 450 par.1 dhe 2, nen par. 2.6 të KPPRK-së.

Vendimi mbi kompensimin e viktimave të krimit është marrë në kuptim të nenit 39 par.  
pika 3.1 të ligjit, Nr.05/L-036, të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Në bazë të së theksuarës më lartë u vendos si në dispozitivit të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**  
**Departamenti Përgjithshëm-Divizioni Penal,**  
**P.nr.2911/17 datë 06.11.2018**

Procesmbajtëse,  
Marigona Shaqiri

Gjyqtarja,

Hakile Ilazi



**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditëve, pas pranimit të kopjes me shkrim të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa i dorëzohet Gjykatës Themelore në Ferizaj.